



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AKADEMIA E SHKENCAVE E SHQIPËRISË  
JURIA

Nr. 6/5 prot.

Tiranë, më 03.04 2018

V E N D I M

Nr. 5 datë 03.04 2018

**Për shpalljen e fituesve të Çmimeve Shkencore Kombëtare Vjetore që akordohen nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Edicioni II, 2017**

Juria e çmimeve shkencore kombëtare që akordohen nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë (më tej: ASHSH), e krijuar me Urdhrin nr. 1, datë 08.01.2018, Për ngritjen dhe përbërjen e jurisë së çmimeve shkencore kombëtare vjetore për vitin 2017; në përmbushje të përgjegjësive të veta dhe referuar në:

- Ligjin nr. 9655, datë. 11.12.2006, Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë, neni 4, pika dh;
- Nenin 14 të Rregullores për themelimin e çmimeve vjetore shkencore kombëtare të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, për mënyrën e organizimit të konkurseve, për kriteret e zgjedhjes së fituesve dhe mënyrën e shpalljes së tyre, miratuar me Urdhrin nr.11, datë 6.10.2016;
- Vendimin nr.13, datë 1.06.2017, Për shpalljen e organizimit të çmimeve shkencore kombëtare të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë për vitin 2017 dhe dokumentin Thirrje për pjesëmarrje në edicionin e dytë të çmimeve shkencore kombëtare të ASHSH për vitin 2017;

Pas shpalljes së të nominuarve prej saj (shih vendimin nr. prot 6/2, datë 26 janar 2018), ndjekjes së ligjëratave publike të autorëve të nominuar dhe në përfundim të procedurës së votimit për shpalljen e fituesit;

**Vendosi:**

1. Të shpallë fitues për Çmimin shkencor kombëtar vjetor "Çabej", që jepet për studimin më të mirë në fushën e shkencave shoqërore albanologjike:

Nr.	Titulli i veprës	Autori	Vota
1.	FJALOR ETIMOLOGJIK I GJUHES SHQIPE	KOLEC TOBALLI	100%

2. Të shpallë fitues për Çmimin shkencor kombëtar vjetor "Radovicka", që jepet për studimin më të mirë në fushën e shkencave natyrore teknike:

Nr.	Titulli i veprës	Autori/Autorët	Vota
1.	HORTIKULTURA-VËSHTRIMI ENCIKLOPEDIK	NAZIM GRUDA ANDREA SHUNDI	100%

3. Të shpallë fitues për Çmimin shkencor kombëtar vjetor për kërkuesin e ri më të suksesshëm në fushën e shkencave shoqërore albanologjike:

Nr.	Titulli i veprës	Autori/Autorët	Vota
1.	ËKSPEDITA NE LUMIN AZOV-GJUHA DHE KULTURA E SHQIPTAREVE TE UKRAINES	A. A. NOVIK, J. V. BUCATSKAYA, D. E. ERMOLIN, A. S. DUGUSHINA, M. S. MOROZOVA	100%

4. Juria e çmimeve shkencore kombëtare që akordohen nga ASHSH falënderon gjithë pjesëmarrësit që iu përgjigjën pozitivisht thirrjes së saj dhe çmon lart punën e tyre kërkimore-shkencore.
5. Juria e çmimeve shkencore kombëtare i propozon Akademisë së Shkencave organizimin e një ceremonie publike për shpalljen e fituesve të edicionit të II-të, të këtyre çmimeve shkencore kombëtare.

**KRYETARI I JURISË**

**AKADEMIK MUZAFER KORKUTI**

